

**GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,  
SEZONI 2023/2024  
(java e 42, deri më 22.10.2023)**

### **TË DHËNA JAVORE**

Gjatë javës së 42-të të vitit 2023 (nga 16-22.10.2023), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 53 raste ( $I=2,9/100.000$  banorë) të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, që është për 19,7% më shumë krahasuar me javën e kaluar ( $n=66$ ). Krahasuar me javën e njëjtë të sezonit ta kaluar ( $n=27$ ) është regjistruar një rritje orej 96,3%, ndërsa në raport me modelin për 13 sezonet e fundit ( $n=37$ ) është regjistruar një rritje për 41,6%.

Të sëmurët e kësaj jave janë rastet e para të raportuara gjatë sezonit të ri dhe janë regjistruar në Dibër – 34, Kumanovë – 7, Gostivar – 4, Radovish – 3, Prilep dhe Shkup nga 2 dhe në Strumicë – 1.

Sa i përket moshës, tek grupmosha 5-14 janë regjistruar 23 persona, tek grupmosha nga 15-64 – 20, nga 0-4 vjet – 10 persona.

Kumulativisht, deri në javën e 42-të, janë regjistruar gjithsej 151 raste ( $I=8,2/100.000$  banorë).

Gjatë javës së 42-të të vitit 2023, pranë laboratorit të virusologjisë të ISHPRMV kanë arritur 33 materiale për analiza laboratorike për gripin, 11 nga mbikëqyrja SARI dhe 22 nga mbikëqyrja e rutinore, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19 dhe të gjitha kanë rezultuar negative për prani të virusit të gripit. 3 persona kanë rezultuar pozitiv për COVID-19.

Kumulativisht deri më tani janë analizuar 100 materiale, të gjitha me rezultat negativ për influencën.

### **MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI (Infeksioneve Respiratore Akute Serioze)**

Në vendet sentinel gjatë kësaj jave janë raportuar gjithsej 32 raste SARI, nga vendet sentinel SARI në Shkup dhe në Shtip. Numri më i madh i rasteve SARI është raportuar nga Instituti për sëmundjet e mushkërive tek fëmijët KOZLE ( $n=16$ ; 50%). Ndërsa sa i përket moshës, numri më i madh i rasteve SARI ( $n=17$ ; 53,1%) janë raportuar në mesin e grupmoshës 0-4 vjet.

Gjatë kësaj jave numri i përgjithshëm i pranimeve në vednet sentinel është 181, pa raste të raportuara në kujdesin intensiv. Nga të gjitha pranimet, 16,7% i përkasin SARI.

Gjatë kësaj jave është regjistruar një rast i vdekjes i raportuar nga një vend sentinel SARI – SK në Shtip, që i përket grupmoshës mbi 65 vjet, pa komorbiditete. Personi i ndjerë ka rezultuar pozitiv për COVID-19.

Kumulativisht, nga të gjitha vendet sentinel, janë raportuar gjithsej 92 raste SARI. Numri më i madh i rasteve SARI (nga  $n=17$ ; 53,1%) janë raportuar në KU e fëmijëve dhe Instituti për sëmundjet e mushkërive tek fëmijët KOZLE. Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numri më i madh i rasteve SARI është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet ( $n=39$ ; 20,3%).

Kumulativisht numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 507, nga të cilët 2 persona janë në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet, 18,1 janë si pasojë e SARI.

Kumulativisht, për analiza laboratorike janë dorëzuar 24 materiale nga rastet e raportuara SARI. Nuk janë regjistruar raste të gripit. Janë regjistruar 6 raste pozitive me Covid-19. 9 janë analizuar për virus respirator sincial, pa raste pozitive. Tek një mostër është detektuar prani e Adeno virus.

### **VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL**

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i Shëndetit Publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2023 /2024, Ministria e Shëndetësisë siguroi 60.000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 15.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Më datën 25.10.2023 filloi vaksinimi kundër gripit sezonal. Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2023/2024 do të zbatohet në Shtëpitë e Shëndetit dhe/ose Qendrat e Shëndetit Publik me Njësitë e tyre Rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes [www.vakcinacija.mk](http://www.vakcinacija.mk).

4.500 vakcina shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të Shëndetit Publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre Rajonale.

## **RAJONI EVROPIAN**

Sipas Raportit të ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary) të publikuar në javën e 41 të vitit 2023, aktiviteti i virusit të gripit është mbi nivelin bazë në 8 vende të Rajonit Evropian të OBSH-së. Krahasuar me javën e 40, virusi i gripit mbetet me aktivitet të ulët, ndërsa aktiviteti i RSV dhe SARS-CoV-2 vazhdon të rritet. Pranimet e reja SARI mbeten në nivel të ulët, ngjashëm me numrin e pranimeve të raportuara gjatë vitit të kaluar, ku numri më i madh i hospitalizimeve ishin si pasojë e SARS-CoV-2.

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive  
Instituti i Shëndetit Publik**